

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Frosina Sylejmani kryetare e kolegjit, Fejzullah Rexhepi dhe Isa Shala anëtar, në çështjen juridike kontestimore të paditësit S.I. nga fshati ..., Komuna e Skenderaj, të cilin e përfaqëson, N.M. avokat nga Prishina, kundër të paditurës Fondi i Garancionit të Kosovës (tani Byroja Kosovare e Sigurimeve BKS) me seli në Prishtinë, të cilën e përfaqëson D.P. sipas autorizimit, për shkak të kompensimit të dëmit, duke vendosur sipas ankesës së të paditurës e paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Dega në Gllogoc, C.nr.195/013, i datës 04.11.2013, në seancën e kolegjit të mbajtur me datën 15.09.2017, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET si e pa bazuar ankesa e të paditurës Fondi i Garancionit të Kosovës (tani Byroja Kosovare e Sigurimeve BKS) me seli në Prishtinë, dhe VËRTETOHET aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Dega në Gllogoc, C.nr.195/012, i datës 04.11.2013, përveç në pjesën që ka të bëjë me kamatën në të cilën pjesë NDRYSHOHET dhe vendoset ashtu që DETYROHET e paditura që paditësit t'ia paguajë kamatën të cilën e paguajnë bankat afariste në Kosovë sikurse për mjetet e deponuara pa destinim të caktuar për një vit, duke filluar nga data e marrjes së aktgjykimit të shkallës së parë 04.11.2013, e deri në pagesën definitive.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë, me aktgjykimin e ankimuar C.nr.195/013, i datës 04.11.2013, me pikën I (një) të dispozitivit e ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit S.I. nga fshati ..., Komuna e Skenderaj dhe e ka detyruar të paditurën Fondi i Garancionit të Kosovës (tani Byroja Kosovare e Sigurimeve BKS) me seli në Prishtinë, që paditësit në emër të dëmit material të shkaktuar në aksidentin e komunikacionit me datën 30.12.2009, në rrugën regjionale Drenas-Skenderaj, pikërisht në fshatin Polluzhë, Komuna e Gllogocit, t'ia paguaj shumën prej 2.000 euro me kamatë ligjore prej 3.5%, të cilat e aplikojnë bankat si në mjetet e afatizuara pa destinim të caktuar kthimi mbi një vit, duke llogaritur prej momentit të marrjes së aktgjykimit e gjer te pagesa definitive si dhe t'ia kompensojë shpenzimet e procedurës kontestimore në shumën 622 Euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi nën kërcënim të përmbarimit me dhunë.

Kundër këtij aktgjykimi e paditura në afat ligjor ka paraqitur ankesë për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike, zbatimit të gabuar të së drejtës materiale dhe vendimit mbi kamatën, ashtu që i propozon gjykatës së shkallës së dytë që të prishë aktgjykimin e atakuar dhe lënda t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rishqyrtim dhe rivendosje ose aktgjykimi i atakuar të ndryshohet dhe Gjykata e Apelit të vendosë vetë lidhur me kërkesëpadinë.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194 dhe 195, të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

Ankesa e të paditurës është e pabazuar, përveç sa i përket kamatës.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi S.I. nga fshati ..., Komuna e Skenderaj përmes të autorizuarit të tij me datë 28.05.2008, në gjykatën e shkallës së parë ka paraqitur padi për kompensimin e dëmit të cilën e ka precizuar me parashtresën e datës 30.12.2009, kundër të paditurës Fondi i Garancionit të Kosovës (tani Byroja Kosovare e Sigurimeve BKS) me seli në Prishtinë, me të cilën ka kërkuar që të detyrohet e paditura që paditësit në emër të kompensimit të dëmit material të pësuar në aksidentin e komunikacionit me datën 06.08.2007, t'ia paguaj shumën prej 2.000 euro me kamatë ligjore prej 3.5%, të cilat e aplikojnë bankat si në mjetet e afatizuara pa destinim të caktuar kthimi mbi një vit, duke llogaritur prej momentit të marrjes së aktgjykimit e gjer te pagesa definitive si dhe t'ia kompensojë shpenzimet e procedurës kontestimore në shumën 622 Euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi nën kërcënim të përmbarrimit me dhunë.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas padisë së paditësit pas shqyrtimit dhe administrimit të provave nga palët ndërgjyqëse si dhe të gjitha shkresat tjera të lëndës konform dispozitës së nenit 8 të LPK-ës, ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar C C.nr.195/013, i datës 04.11.2013, me të cilën e ka aprovuar si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit, duke vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar.

Në arsyetim të aktgjykimit të atakuar gjykata e shkallës ka theksuar se me datën 06.08.2007, rreth orës 13:30 minuta në rrugën regjionale Drenas – Skenderaj, pikërisht në fshatin Polluzhë, Komuna e Gillogocit ka ndodhur aksidenti i komunikacionit, ku drejtuesi i automjetit K.S. duke drejtuar automjetin në rrugën regjionale nga Skenderaj në drejtim të Drenasit dhe kur ka arritur në fshatin Polluzhë ka filluar tejkalimin e kundërligjshëm të automjetit “Golf” që ishte i ndaluar para tij, pa u bindur se e këtë veprim nuk i rrezikon pjesëmarrësit tjerë në komunikacion dhe në atë çast ndeshet drejtëpërdrejtë me automjetin e tipit “Kombi” të cilin ishte duke e vozitur paditësi, me ç'rast i shkakton paditësit dëm material në automjetin e tij.

Gjykata ka shtuar se në cilësi të provës materiale ka administruar edhe ekspertizën e ekspertit të komunikacionit të Ing. R.B. në të cilat është marrë na shkresat e lëndës penale GJPP.nr.115/07 e datës 05.10.2007, prej së cilës vërtetohet se deri te aksidenti i komunikacionit ka ardhur me fajin ekskluziv të drejtuesit të automjetit AVË “Kombi” K.S. i cili duke ndërmarrë veprim të tejkalimit në mënyrë të pasigurtë, duke mos u bindur se mund të bëjë një veprim të tillë duke mos i rrezikuar pjesëmarrësit tjerë në komunikacion, godet automjetin BVË “Cravella Kombi” i cili ishte duke qarkulluar në shiritin që i takon për levizje.

Për të vërtetuar lartësinë e kërkesëpadisë gjykata në procedurën e provave ka nxjerrë ekspertizën e ekspertit të vlerësimit të dëmeve ing. G.M. të datës 12.12.2009, ku ka konstatuar se vlera për shpërblim për dëm të automjetit është 2.000 euro, i cili është llogaritur si dëm total, ku eksperti me rastin e përlllogaritjes së dëmit ka pasur parasysh vlerësimin e bërë sipas procesverbalit mbi dëmin e automjetit nga ana e Kompanisë “Sigal” të datës 29.08.2007 si dhe shiqimit të fotodokumentacionit, për çka dëmi është trajtuar si dëm total, meqë nuk ka mundësi të riparohet dhe të kthehet në gjendjen e mëparshme.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson së qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika (b), (g), (j), (k) dhe (m) e LPK-së, dhe e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë përveç në pjesën e kërkesëpadisë që ka të bëjë me kamatën, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore për shkeljet e dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika (n) e LPK-së, pasi që dispozitivi i aktgjykimit është mjaft i qartë dhe në përputhje të plotë me arsyet e aktgjykimit. Arsyetimi i aktgjykimit përmban arsyeje të mjaftueshme për faktet vendimtare të çështjes për provat e administruar në lidhje me vërtetimin e fakteve dhe për vlerësimin e gjykatës në lidhje me mënyrën se si i ka vërtetuar faktet.

Nuk qëndrojnë pretendimet e të paditurës përvërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, pasi që nga shkresat e lëndës konstatohet se të gjitha faktet e çështjes përveç atyre që kanë qenë jo kontestuese janë provuar me prova përkatëse të cilat janë administruar në një proces të rregullt gjyqësor. Në mënyrë specifike për këtë bazë e paditura i është referuar vërtetimit jo të plotë të gjendjes faktike sa i përket kundërshtimeve në lidhje me ekspertizen e ekspertëve të komunikacionit dhe atyre të makinerisë, të cilin pretendim ankimor Gjykata e Apelit nuk e ka pranuar si të themeltë. Nga ekspertiza e ekspertit të komunikacionit dhe atij të makinerisë është vërtetuar në mënyrë të plotë gjendja faktike.

Duke marrë në konsideratë ekspertizën Gjykata e Apelit vlerëson se është krijuar baza që paditësit ti pranohen kompensimi për dëmin material, ndërsa sa i përket lartësisë është pranuar vendimi i gjykatës së shkallës së parë, pasi që shumica e gjykuar është në përputhje me dëmin e shkaktuar.

Lidhur me pjesën e ndryshuar të aktgjykimit të atakuar sa i përket kamatës, Gjykata e Apelit duke u kujdesur sipas detyrës zyrtare për zbatimin e së drejtës materiale, ka bërë ndryshimin e aktgjykimit në kuptim të dispozitës së nenit 195 paragrafi 1 pika (e) e lidhur me nenin 201 paragrafi 1 pika (d) e LPK-së, meqenëse ka gjetur se nuk ka shkelje esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe plotësisht, por sipas kësaj gjendje faktike të vërtetuar nga gjykata e shkallës së parë është zbatuar gabimisht e drejta materiale, për çka është dashur që të ndryshohet aktgjykimi i atakuar.

Në këtë rast është zbatuar në mënyrë të gabuar dispozita e nenit 277 e LMD-së, pasi që kamata nuk është përcaktuar në përputhshmëri me këtë dispozitë.

Nga sa u tha më lart u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi e në bazë të nenit 195 paragrafi 1 pika (d) dhe (e) të LPK-së.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË

Ac.nr.92/14, me datë 15.09.2017

Kryetare e kolegjit
Frosina Sylejmani